

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN LEKBIBAJ, TROPOJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Lekbibaj, Tropojë**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifatat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 98, datë 02.08.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 449/6, datë 02.8.2014, i ka rekomanduar z. Gëzim Meshi Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Komuna Lekbibaj të analizoje Raportin e Auditimit të KLSH-së në mbledhjen me të afert të Keshillit Komunes.

Menjehere.

2. Komuna Lekbibaj të reduktojë organiken e administrates, duke shkurtuar disa vende pune që nuk kanë ngarkesën e duhur si dhe të zëvendësojë punonjësit pa arsimin përkatës dhe pa përvojën e duhur të punës, me miratimin e keshillit të komunes.

Brenda muajit Shtator 2014

3. Komuna Lekbibaj të marrë masa të sistemojë dokumentacionin e finances dhe prokurimeve publike dhe të bëjë arshivimin e tyre me inventare të rregullt, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për Arkivat”*.

Menjehere.

4. Komuna Lekbibaj të shqytojë në Keshillin e Komunes zgjidhjen e konfliktit të interesit të keshilltarit komunes Pal Bushatit, pasi ai në Keshillin Komunes merr pjesë në miratimin e ndihmes ekonomike dhe nga ana tjetër kryen detyrën e arkëtarit dhe shpërndarësit të kësaj ndihme, çka është në papajtueshmëri me funksionin e këshilltarit, në kundërshtim me nenin 25 pika dhe nenin 30 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, me ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”* neni 3,4/a etj

Menjehere.

5. Komuna Lekbibaj të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e disa taksave dhe tarifave vendore përkatësisht të biznesit vogël, takses së tokës bujqësore, takses kullotave, takses veterinerë, takses gjëetise, për mjetet e transportit etj, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për taksat e tarifatat vendore”* i ndryshuar.

Menjehere.

6. Komuna Lekbibaj të rinovojë kontratat e qerave të antenave dhe kontratën me firmën e huaj Izraelite, për dhënie me qera dhe me koncension të një sipërfaqeje toke, aktivitete këto që kryhen në territorin e komunes.

Menjehere.

7. Komuna Lekbibaj të marrë masat, për administrimin, regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në ZVRPP B.Curri, sipas kërkesave të VKM nr. 222, datë 13.2.2008 “Për kalimin përfundimtarë pyje dhe kullota në pronësi të Komunes”, të UMPVD nr. 15, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të palujtshme publike”, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, kreu III-të “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të ligjit nr.9385, datë 04.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal dhe të VKM-se nr.253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”.

Menjehere.

8. Komuna Lekbibaj të marrë masa për venien në funksionim të shkolles Brise dhe Btoshe, në të kundërt në mungesë të nxenesve, të shikojë mundësinë e ndërrimit të destinacionit të tyre, për ta shfrytëzuar për nevojat tjera emergjente të komunitetit, me miratim të keshillit komunal.

Brenda muajit Shtator 2014.

9. Komuna Lekbibaj të blloktojë shërbimet me vlera vogla, përjashtuar ndonjë rast emergjent, pasi për periudhën 2011-2013 nuk kanë qenë efektive dhe të dukshme, madje kanë qenë objekt i letrave të komunitetit, ku fitues kanë qenë disa oferta, të afert familjar të tyre.

Vazhdimisht

10. Zyra e Financës së komunes, të bëjë hyrje “Projektin dhe studimin e Qendres Lekbibaj”, hartuar nga subjekti “P...Y”, për vlerën **300,000 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 162, datë 7.12.2012 dhe fatures nr. 8, datë 5.12.2012, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjehere

11. Komuna Lekbibaj të marrë masat për tërheqjen dhe administrimin pranë komunes, **te 5 mjeteve të transportit** për vlerën **5,299,950 leke**, të cilat përdoren padrejtësisht nga ish-drejtnesit e mëparshëm të komunes, në të kundërt të detyrojnë ata të zhdëmtojnë vlerën e tyre, përkatësisht 3 Tajota, 1 kamion dhe 1 Ambulance, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.10.296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda muajit Shtator 2014

12. Zyra e Financës së komunes Lekbibaj të marrë masa, për arketimin e vlerës **571,533 lekë**, për zbulime të lëna nga auditimet e mëparshme dhe të pa arketuara nga komuna, përkatësisht: vlera 95,500 leke nga auditimi i Ministrisë Brendshme, vlera 56,600 leke dhe 419,433 leke nga 2 auditimet e Prefekturës Kukes (vlera 277.433 leke nga subjekti “R...” shpk, për pagesën e shtesës së kontratës për investimin “Ndërtim i shkolles 9-vjecare Brise” të përfituar padrejtësisht si dhe vlera 142.000 leke nga gjashtë familje për ndihmë ekonomike, përfituar padrejtësisht në periudhën Janar-Dhjetor 2013).

Brenda muajit Shtator 2014

13. Komuna Lekbibaj të marrë masa për arketimin e vlerës **600,000 leke mungesë të ardhurash**, për qerata e 2 antenave të papaguara për vitin 2011, përkatësisht; SHA “A...” për 300,000 leke dhe SHA “V...” 300,000 leke, në kundërshtim me kontratën datë 02.8.2004 dhe kontratën datë 18.11.2004, në të kundërt komuna të heqë antenat nga territori i saj.

Brenda muajit Shtator 2014

14. Komuna Lekbibaj të **perlllogarit penalitetet në masën 4/1000**, për vonesën në përfundim të punimeve për objektin “Rikonstruksion i rrugës 60 km” ndaj “R... shpk”, në zbatim të

kontratës datë 15.01.2014, me afat zbatimi kontraktor 105 ditë nga dita e fillimit të punimeve në kantier, afat i cili nuk është respektuar.

Menjehere.

15. Komuna Lekbibaj, ti kerkoje Agjensises te Prokurimit Publik:

a. përjashtimin e kontraktorit “R...” nga pjesëmarrja ne prokurimet publike per nje periudhe 2 vjeçare, per mos zbatim kontrate, pra për punime te pakryera ne masen 50% ose ne vleren 778,461 leke pa TVSH (nga 1,8 milion vlera kontraktore), ne objektin “Ndertim shkolla Brise” , bazuar ne nenin 13, pika 3/ç, te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Udhezimit te KM-se, nr. 1, date 10.01.2007 “Per Rregullat e Prokurimit publik” i ndryshuar. KREU i VII, pika 2, “Mbikqyrja e Kontrates”. Gjithashtu per mos përfundimin ne afat te objektit “Rikonstruksion i rruges 60 km ”, sipas kontrates date 15.01.2014 lidhur ndermjet Komunes Lekbibaj dhe subjektit “R...” shpk.

b. përjashtimin e kontraktorit “K...” nga pjesëmarrja ne prokurimet publike per nje periudhe 2 vjeçare, per punime te pakryera ne masen 50% ose ne vleren 886,440 leke pa TVSH (nga 1,8 milion vlera kontraktore), ne objektin “Rikonstruksionin e shkollave 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe”, sipas kontrates nr. 114 , datë 29.08.2012 lidhur ndermjet Komunes Lekbibaj dhe subjektit “K...” shpk, bazuar ne nenin 13, pika 3/ç, te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Udhezimit te KM-se, nr. 1, date 10.01.2007 “Per Rregullat e Prokurimit publik” i ndryshuar. Kreu i VII, pika 2, “Mbikqyrja e Kontrates”.

Brenda muajit Shtator 2014

MASA PER SHPERBLIM DEMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbartimor, me qëllim **arkëtimit** e vlerës **3,665,211 leke dëm ekonomik**, konkretisht:

1. vlera 20,000 lekë, per **shpenzime celulare** perfituar teper per vitin 2012 nga G.M., në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pika 9.

Brenda muajit Shtator 2014

2. vlera 194,360 leke, per **pagesa te paligjshme**, perkatesisht: D.C. 13,120 leke, M.S. 13,120 leke, Gj.Gj. 13,120 leke, E.P. 25,000 leke, H.P. 9,900 leke, Gj.L. 14,850 leke, J.N. 14,850 leke, A.R. 14,850 leke, P.I. 9,900 leke, F.Zh. 9,900 leke, V.Gj. 9,900 leke, A.B. 4,950 leke, P.P.4,950 leke, ne kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Brenda muajit Tetor 2014

3. vleren 50,000 leke TVSH , perfituar padrejtesisht TVSH nga subjekti “K...”, pasi fatura e subjektit nuk është e modelit tatimor me TVSH, ne kundërshtim me VKM nr.1149, date 25.11.2009 “Per shtypjen dhe shperndarjen e dokumentit tatimor”, me UMF nr.52, date 28.12.2009 ndryshuar me udhëzimin nr.2, date 7.01.2011.

Menjehere

4. vleren 240,000 lekë, per blerje **pjesë kembimi** per furgonin Wolkswagen, pasi shpenzimi i riparimit kapital te tij ka kaluar limitin ligjor 50 % te vleres fillestare te furgonit te sapo blere, ne ngarkim te G.M. 48,000 leke, V.R. 48,000 leke, V.L. 48,000 leke, M.N. 48,000 leke dhe

N.Gj. 48,000 leke, veprim ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Brenda muajit Tetor 2014

5. vleren 333,000 lekë, likuidim i gabuar per subjekti fizik E.Rr. per projektin 60 km rruge rurale, ne vend te likuidimit per “D...N” shpk i cili ka bere projektin sipas kontrates date 01.11.2013, veprim ne kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda muajit Dhjetor 2014

6. vlera 52,000 leke, per diferenca inventari ne artikullin sensor levizje FV per 13 cope, pasi nga 21 cope sipas situacionit te firmes gjenden 8 cope te vendosura ne godinen e komunes, per komisionin e blerjeve V.L. 17,332 leke, M.N. 17,334 leke dhe V.RR. 17,334 leke, ne kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjehere

7. vlera 40,000 lekë, shpenzimi i pa justifikuar me dokumenta, për mirmbajtje rruge makine Qender- Peraj, per subjektin E.RR., ne kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjehere

8. vlera 363,300 leke, per aktivitete social kulturore te paligjshme, per 1 udhetim turistik dhe 1 dreke, perkatesisht: G.M. 51,900 leke, V.Rr. 51,900 leke, V.L. 51,900 leke, M.N. 51,900 leke, N.Gj. 51,900 leke, A.N. 51,900 leke, J. M. 51,900 leke, ne kundërshtim me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, me piken 1.b te VKM nr.472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” dhe me pikën 2 dhe 9 të VKM nr.929, datë 17.11.2010 “ për krijimin e përdorimin e fondit veçantë”, me piken 1/c dhe 9 te VKM nr.243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr.258, datë 3.6.1999, me piken 5 te VKM nr.432 datë 28.06.2006 “per krijimin dhe administrimin e te ardhurave qe krijojne institucionet buxhetore”.

Brenda muajit Nentor 2014

9. vlera 500,000 leke, perfitim dieta te pa justifikuara per vitin 2012 dhe 2013, perkatesisht: G.M. 100,000 leke, B.M. 70,000 leke, A.N. 50,000 leke, V.L. 30,000 leke, N.Gj. 40,000 leke, M.N. 40,000 leke, A.Q. 90,000 leke dhe H.P. 10,000 leke, V.Rr. 50,000 leke dhe J.M. 20,000 leke, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,

Brenda muajit Dhjetor 2014

10. vlera 199,800 leke, per tejkalim normative te karburantit për vitin 2012 dhe 2013, për B.M., ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Brenda muajit Dhjetor 2014

11. vlera 866,440 lekë pa T.V.SH, per **punime te pakryera,** përfituar nga sipërmarrësi “K...” Sh.p.k, per “Rikonstruksionin e shkollave 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe”, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit“, neni 7.

Brenda muajit Nëntor 2014

12. vlera **778,461 lekë** pa T.V.SH, per ***punime te pakryera*** përfituar nga sipërmarrësi “**R...**” Sh.p.k per “*Ndertimin e shkolles Brise*”, në kundërshtim me ligjin nr, 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, neni 7.

Brenda muajit Nëntor 2014

13. Vlera **27,850 lekë**, per projekt-preventivuesin N.Gj. për objektet “*Rikonstruksion Shkolla – 9 vjecare Tetaj*” dhe “*Rikonstruksion Shkolla – 9 vjecare Btoshe*”, pasi ka ***rritje te gabuar të fondit limit*** për realizimin e objekteve, në kundërshtim me vendimin nr.514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, pikat 2, 3 dhe 9.

Brenda muajit Nëntor 2014

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, bazuar në Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “*Sanksione*”, pika 1, shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, i rekomandojmë Komisionit të dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, **për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:**

A. Heqjen e Licencës, për një afat prej 1 (një) viti, të 1 mbikëqyrësi dhe 1(nje) kolaudatori të punimeve të ndërtimit, respektivisht:

1. z. B.S., mbikëqyrës i punimeve me liçence nr. MK 1554/4 date 7.11.2011, lidhur sipas kontrates date 29.8.2012.

Për arsyet e mëposhtme:

-Për punime të pakryera në masën 50% (*vlera kontraktore 1,8 milion leke*) ose në vlerë absolute 866,440 lekë dëm ekonomik pa T.V.SH për investimet “*Rikonstruksionin e shkollave 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe*”.

- Nuk është zbatuar ligji nr, 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, dhe konkretisht neni 7 ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit*.

-Krahas punimeve të pakryera u konstatua se : Struktura mbajtëse prej druri rezulton pa projekt, çka nuk do të garantonte siguri nëse objekti do të ishte i shfrytëzueshëm; Gjithashtu në një prej klasave tavani prej derrase rezulton i rrëzuar dhe po në këtë klasë ka akoma lëndë druri të papastruara që nga koha e punimeve në këtë objekt.

2. zj. F.V., kolaudatore e punimeve me liçence nr. MK 1706/4.

Për arsyet e mëposhtme:

-Për kolaudimin e objektit me punime të pakryera në masën 50% ose në vlerë absolute 866,440 lekë dëm ekonomik pa T.V.SH (*vlera kontraktore 1,8 milion leke*), për investimet “*Rikonstruksionin e shkollës 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe*”.

- Nuk është zbatuar ligji nr, 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, dhe konkretisht neni 12 ku përcaktohet se: *Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:*

- 1- objekti është realizuar në kushtet teknike;
 - 2- objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
 - 3- çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës;
 - 4- në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve;
- Krahas punimeve të pakryera u konstatua se : Struktura mbajtëse prej druri rezulton pa projekt, çka nuk do të garantonte siguri nëse objekti do të ishte i shfrytëzueshëm; Gjithashtu në një prej klasave tavani prej derrase rezulton i rrëzuar dhe po në këtë klasë ka akoma lëndë druri të papastruara që nga koha e punimeve në këtë objekt.

B. Heqjen e Licencës, për një afat prej 1 (një) viti, të 1 mbikëqyrësi dhe 1(nje) kolaudatori të punimeve të ndërtimit, respektivisht:

3. z. K.S., mbikëqyrës i punimeve me licence nr. MK..

Për arsyet e mëposhtme:

-Për punime të pakryera në masën 50% ose në vlerë absolute 778,461 lekë dëm ekonomik pa T.V.SH për investimin “Ndertim shkolla-9 vjeçare Brisë” (vlera kontrakt 1,8 milion leke).

- Nuk është zbatuar ligji nr, 8402, datë 10.09.1998 ”Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“, dhe konkretisht neni 7 ku përcaktohet se: Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit .

4. z. L.K., kolaudator i punimeve me licence nr. MK 2052.

Për arsyet e mëposhtme:

-Për kolaudimin e objektit me punime të pakryera në masën 50% ose në vlerë absolute 778,461 lekë dëm ekonomik pa T.V.SH për investimin “Ndertim shkolla-9 vjeçare Brisë” (vlera kontraktore 1,8 milion leke).

-Nuk është zbatuar ligji nr, 8402, datë 10.09.1998 ”Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“, dhe konkretisht neni 12 ku përcaktohet se: Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

- 1- objekti është realizuar në kushtet teknike;
- 2- objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
- 3- çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës;
- 4- në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve;

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 144 ,153 dhe 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, **kërkojmë** që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, **kryetari i Komunes Lekbibaj të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore**, si më poshtë:

“Zgjidhje e Kontratë së Punës”, per:

1. V.RR., me detyrë **Përgjegjese e finances** se Komunes (2013) dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues, komisioneres blerjeve dhe shërbimeve të vogla, anetare e njesise prokurimeve publike, për shkeljet e mëposhtme:

-Per kryerjen e detyrës se përgjegjëses financës, ne kushtet pa përvojë pune financiare dhe pa diplomë universitare të nivelit dytë në shkencat ekonomike, në kundërshtim me nenin 12 pika 1 të ligjit nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Per mangesi dhe shkelje ne mbajtjen dhe organizimit te kontabilitetit dhe mbylljes se llogarise vjetore per vitin 2013, pasi nuk eshte mbajtur ditari i pagave, partitari i pagave, partitari i magazines, kartelat dyfish te inventareve, ditari i veprimeve te ndryshme, centralizatori, si dhe veprimet e mbylljes se bilancit 2013 jane bere ekstrakontabel. Per anomali ne mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit te finances, pasi ai nuk eshte i lidhur, nuk eshte i sistemuar dhe i etiketuar sipas viteve buxhetore. Veprime ne kundërshtim me ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me VKM nr.25, date 20.01.2001 “Per disa shtesa dhe ndryshime” me VKM nr. 248, date 10.04.1998 “ Per miratimin e planit kontabel publik, per organet e pushtetit lokal, institucionet shtetore,qendrore e lokale, si dhe njesive qe varen prej tyre”, si dhe me VKM nr.783, date 22.11.2006 “Per percaktimin e standarteve dhe rregullave kontabel”, si dhe me udhezimin nr.14, date 28.12.2006 “ Per pergatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore per institucionet qendrore,organet e pushtetit vendor dhe njesive qe varen prej tyre, si dhe njesive te menaxhimit/zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donator te huaj”, i ndryshuar me udhezimin nr.26, date 27.12.2007 dhe me udhezimin nr.10, date 27.02.2008.

-Per lejimin e pagesave paligjshme per vleren 194,360 leke dem ekonomik, per 16 raste, ne kundërshtim me udhezimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

-Per lejimin e pagesave te kundraligjshme per 2 aktivitete social kulturore per vleren 363,300 leke dem ekonomik, ne kundërshtim me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, me piken 1.b te VKM nr.472, datë 02.7.2011”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” .

-Per pagesa dieta te teperta dhe te pajustificuara me dokumentacion per vleren 250,000 leke per vitin 2013, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

-Per lejimin e tejkallimit te normatives se karburantit per vleren 73,000 leke dem ekonomik, per vitin 2013 dhe per parregullsi ne dokumentacionin e tyre, ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhezimin nr. 30, datë 27.12.2011.

-Per mos zhvillim tenderi ne vitin 2013 per vleren 1,546,664 leke, por është proceduar me prokurim të drejtpërdrejtë duke copëzuar fondin, per grup sherbimesh te njejta brenda vitit kalendarik 2013 ne 7 raste, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me kreun II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” pika 1 “Kufijtë monetarë” shkronja B, me kreun IV shkronja C dhe me udhezimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 4, me ndryshime sipas UAPP nr. 01, datë 9.3.2011.

-Per disa shkelje ne blerjet dhe sherbimet me vlera te vogla, te cilat ishin përqendruar ne 2-3 subjekte fizike dhe juridike te aferm te saj, dhe disa nga keto subjekte nuk kane patur licenca perkatese per artikujt e blere, çka bie ndesh me piken 5 te Udhëzimit Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla me ndryshime sipas UAPP nr. 1 date 9.3.2011.

-Per mos kontabilizimin e vleres 419,433 leke dhe zbatimin e pjesshem te rekomandimeve te lëna nga auditimet e brendshme, ne kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për

kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me urdhërin nr.70, datë 18.4.2006 të Kryeministrit *’Per zbatimin e rekomandimeve te Kontrollit Shtetit dhe Auditit Brendshem’* dhe me nenin 10 te ligjit nr.10279 dt 20.05.2010 *“Per kundravajtjen administrative “* dhe nenin 37 te ligjit nr.7961 dt 12.07.1995 *“ Kodi i Punes “*, i ndryshuar.

-Per shkelje ne marrjen ne dorëzim te objektit *“Ndertim shkolla 9-vjecare Brise”*, me punime te pakryera per vleren 50 % ndaj totalit vleres kontrates, ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, date 10.09.1998 *“Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, date 15.03.2001.

2. A.N., me detyrë **ish-Pergjegjes i finances (2012)** dhe në cilësinë **e antarit te KVO** dhe te Njesise Prokurimit dhe komisionerit blerjeve dhe shërbimeve te vogla, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin e padrejte dhe shpalljen fitues ne 3 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues *shpk “R...”* dhe *shpk “K...”*, ne tenderin *“Rikonstruksion rruge 60 km te brendshme”*, *“Ndertim shkolla 9-vjecare Brise”* dhe blerja e *“Fadromes”*, ne kushtet e mungeses kritereve per kualifikim dhe mangësive ne dokumentacion, ne kundërshtim me në bazë të VKM nr.1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, *“Mungesa e konkurrencës”*, germa *“a”*.

-Per shkelje ne marrjen ne dorëzim te objektit *“Rikonstruksion shkolla 9-vjecare Btoshe”* me punime te pakryera per vleren 50 % ndaj totalit vleres kontrates, ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, date 10.09.1998 *“Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, date 15.03.2001.

-Per shkelje ne hartimin e disa dokumentave standarte te tenderit *“Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare Tetaj”*, viti 2012, *(specifikimeve teknike per makinerite)*, ne kundërshtim me nenin 23, pika 5 të ligjit në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimet Publike”*, ndryshuar me ligji nr.9800, datë 10.09.2007.

-Per kryerjen e detyrës se përgjegjësit financës per vitin 2012 pa arsimin perkates veteriner i mesem, në kundërshtim me nenin 12 pika 1 të ligjit nr.10.296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

- Per mangesi dhe shkelje ne mbajtjen dhe organizimit te kontabilitetit dhe mbylljes se llogarise vjetore per vitin 2012, pasi nuk eshte mbajtur ditari i pagave, partitari i magazines, ditari i veprimeve te ndryshme, centralizatori, si dhe veprimet e mbylljes se bilancit 2012 jane bere ekstrakontabel. Veprime ne kundërshtim me ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 *“Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* me VKM nr. 248, date 10.04.1998 *“ Per miratimin e planit kontabel publik, per organet e pushtetit lokal, institucionet shteterore,qendrore e lokale, si dhe njesive qe varen prej tyre”*, si dhe me VKM nr.783, date 22.11.2006 *“Per percaktimin e standarteve dhe rregullave kontabel”*, si dhe me udhezimin nr.14, date 28.12.2006 *“ Per pergatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore per institucionet qendrore,organet e pushtetit vendor dhe njesive qe varen prej tyre, si dhe njesive te menaxhimit/zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donator te huaj”*, i ndryshuar me udhezimin nr.26, date 27.12.2007 dhe me udhezimin nr.10, date 27.02.2008.

-Per pagesa dieta te teperta dhe te pajustificuara me dokumentacion per vleren 250,000 leke per vitin 2012, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 *“Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”*.

-Per lejimin e tejkalimit te normatives se karburantit per vleren 126,900 leke dem ekonomik, per vitin 2012 dhe per parregullsi ne dokumentacionin e tyre, ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

-Per disa shkelje ne blerjet dhe sherbimet me vlere te vogla, çka bie ndesh me Udhëzimin Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 *“Për procedurën e prokurimit me vlere të vogla me ndryshime sipas UAPP nr. 1 date 9.3.2011.*

3. N.G.J., me detyrë **teknik i Komunes** Lekbibaj dhe në cilësinë e **antarit te KV0** dhe te Njesise Prokurimit dhe komisionit blerjeve dhe sherbimeve te vogla, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin e padrejte dhe shpalljen fitues ne 4 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues *shpk “R...”* dhe *shpk “K...”*, ne tenderin *“Rikonstruksion rruge 60 km te brendshme”, “Ndertim shkolla 9-vjecare Brise”, “Rikonstruksion shkolla 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe”* dhe blerja e *“Fadromes”*, ne kushtet e mungeses kritereve per kualifikim dhe mangësive ne dokumentacion, ne kundërshtim me në bazë të VKM nr.1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, *“Mungesa e konkurrencës”*, germa *“a”*.

-Per shkelje ne marrjen ne dorëzim te objekteve *“Rikonstruksion shkolla 9-vjecare Btoshe”* dhe *“Ndertim shkolla 9-vjecare Brise”*, me punime te pakryera per vleren 50 % ndaj totalit vleres kontrates dhe mangësi ne drejtim te zbatimit te projekteve te miratuara, ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, date 10.09.1998 *“Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, date 15.03.2001.

-Per shkelje ne 4 raste, ne cilesine e preventivuesit dhe teknikut per ndjekjen e punimeve, per sherbimet me vlere te vogla, per meremetime rrugesh, lyerje shkollash etj, te cilat nuk kane gene eficente dhe jane shoqeruar me nje dokumentacion memangesi, ne kundërshtim me Udhëzimin Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 *“Për procedurën e prokurimit me vlere të vogla me ndryshime sipas UAPP nr. 1 date 9.3.2011.*

4. A.Q., me detyrë **ish-arketar e magazinjer** i Komunes Lekbibaj dhe në cilësinë e **kryetarit dhe antarit te KV0**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin e padrejte dhe shpalljen fitues ne 4 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues *shpk “R...”* dhe *shpk “K...”*, ne tenderin *“Rikonstruksion rruge 60 km te brendshme”, “Ndertim shkolla 9-vjecare Brise”, “Rikonstruksion shkolla 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe”* dhe blerja e *“Fadromes”*, ne kushtet e mungeses kritereve per kualifikim dhe mangësive ne dokumentacion, ne kundërshtim me në bazë të VKM nr.1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, *“Mungesa e konkurrencës”*, germa *“a”*.

-Per lejimin e tejkallimit te normatives se karburantit per vleren 73,000 leke dem ekonomik, per vitin 2013 dhe per parregullsi ne dokumentacionin e tyre, ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

5. B.M., me detyrë **polic dhe shofer** i komunes, për shkeljet e mëposhtme:

-Per emërim te paligjshem ne detyren e *policit komunar*, në kundërshtim me Rregulloren e Brëndshme *“TIP”* të Policisë të miratuar me Urdhërin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit, nr.1 datë 17.04.2003, *Neni 11 “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”*, pika 2, pika 5 e urdhërit të mësipërm dhe nenin 4 të ligjit Nr. 8224, datë 15.5.1997 *“Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”*, me ligjin nr.8335, datë 23.04.1998.

-Per ushtrimin e detyres se *shoferit* te Komunes Lekbibaj ne konflikt interesi me kryetarin e komunes, sipas kontrates se punes nga viti 2011-2013 , ne kundërshtim me kërkesat e nenit 1, nenit 3/1, nenit 4/1/a.i, nenit 5/1.i, nenit 6/1 , neni 21/1,a dhe neni 21 pika 3/b, neni 37/3,8, neni 38/1 pika i te ligjit nr. 9367, date 7.4.2005 *“Per parandalimin e konfliktit te interesit ne ushtrimin e funksioneve publike”* si dhe me piken 1/a e b, 2,3 e 4 te nenit 37 te ligjit nr.8485, date 12.5.1999 *“Kodin e Procedurave Administrative”*.

6. H.P., me detyre **pergjegjes sherbimesh**, për shkeljet e mëposhtme:

-Per mos funksionim ne kete vend pune, per pune te padokumentuar per vitin 2013, per mos disponim urdhera dhe programe pune, per mungese ngarkese ne kete vend pune, per mos justifikim te pageses se marre. Veprime ne kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

7. E.P., me detyre **vrojtes pyjesh**, për shkeljet e mëposhtme:

-Per mos funksionim ne kete vend pune, per pune te padokumentuar per vitin 2013, per mos disponim urdhera dhe programe pune, per mungese ngarkese ne kete vend pune, per mos justifikim te pageses se marre. Veprime ne kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

8. B.A. me detyre **shofer fadrome**, për shkeljet e mëposhtme:

-Per mos paisje me patenten perkate per drejtimin e mjeteve te renda Fadrome, ne kundërshtim me rregullat e qarkullimit rrugor.

-Per mos funksionim ne kete vend pune, per pune te padokumentuar per vitin 2013, per mos disponim urdhera dhe programe pune, per mungese ngarkese ne kete vend pune, per mos justifikim te pageses se marre. Veprime ne kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9. B.ZH., me detyre **Sanitare** e Komunes, për shkeljet e mëposhtme:

- Per mos kryerjen edetyres dhe mos paraqitje ne pune per nje periudhe te gjate mbi 2 muaj, sipas 2 aktverifikimeve te kryera nga grupi i KLSH. Veprime ne kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

“Vrejtje me paralajmërim”, per:

10. J.M., me detyre **sekretar keshilli** dhe në cilësinë e **kryetarit te KV0** dhe te Njesise Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin e padrejte dhe shpalljen fitues për operatorin ekonomik fitues *shpk “Kupa”*, ne tenderin “Rikonstruksion shkolla 9-vjecare Tetaj dhe Btoshe”, ne kushtet e mungeses kritereve per kualifikim dhe mangësive ne dokumentacion, ne kundërshtim me në bazë të VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

-Per lejimin e pagesave te paligjshme te disa keshilltareve te komunes per vleren 94,050 leke dem ekonomik, pasi nuk kane marre pjese ne mbledhjet e keshillit dhe kane perfituar page padrejtesisht, per 4-mujorin III –te te vitit 2013, ne kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

11. M.N. me detyrë **pergjegjes i administrates** dhe ne cilesine e antarit te njesise se prokurimit publik dhe antarit komisionit blerjeve vogla, për shkeljet e mëposhtme:

-Per shkelje teknike ne hartimin e disa dokumentave standarte te tenderit “Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare Tetaj-Komuna Lekbibaj”, viti 2012, (*specifikimeve teknike per makinerite*), ne kundërshtim me nenin 23, pika 5 të ligjit në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet Publike”, ndryshuar me ligji nr.9800, datë 10.09.2007.

-Per lejimin e pagesave paligjshme per vleren 100,310 leke dem ekonomik, ne kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me

VKM nr.472, datë 02.7.2011”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

-Per disa shkelje ne blerjet dhe shërbimet me vlera te vogla, çka bie ndesh me Udhëzimin Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla me ndryshime sipas UAPP nr. 1 date 9.3.2011.

12. V.L., me detyre jurist, ne cilesine e antarit te **njesise se prokurimit publik dhe kryetar komisioni i blerjeve vogla,** për shkeljet e mëposhtme:

-Per shkelje teknike ne hartimin e disa dokumentave standarte te tenderit ”Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare Tetaj-Komuna Lekbibaj”, viti 2012, (specifikimeve teknike per makinerite), ne kundërshtim me nenin 23, pika 5 të ligjit në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet Publike”, ndryshuar me ligji nr.9800, datë 10.09.2007.

-Per mos inventarizim dhe arshivim te dosjeve te tenderave te vitit 2011, 2012 dhe 2013, ne kundërshtim me ligjin nr.9154, date 6.11.2003 “Per Arkivat”.

-Per mos dërgim pranë APP, rregjistrat e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me përcaktimet në nenin 12 pika 4 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Kreun I-rë pika 3 shkronja “b” e “dh” të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

-Per mos zhvillim tenderi ne vitin 2013 per vleren 1,546,664 leke, per grup shërbimesh te njejta brenda vitit kalendarik 2013 ne 7 raste, duke copëzuar fondin, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me kreun II ”Rregullat e përgjithshme të prokurimit” pika 1 “Kufijtë monetarë” shkronja B, me kreun IV shkronja C dhe me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 4, me ndryshime sipas UAPP nr. 01, datë 9.3.2011.

-Per disa shkelje ne blerjet dhe shërbimet me vlera te vogla, ne kundërshtim me Udhëzimin Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla me ndryshime sipas UAPP nr. 1 date 9.3.2011.

13. F.P., me detyre magazinier i komunes, per shkeljet e meposhtme:

-Per mangesi dhe parregullsi ne mbajtjen dhe azhurnimin e dokumentacionit te magazines.

-Per prerje fletdalje te kaburantit per automjetin e komunes tej normative te miratuar, çka ka shkaktuar nje efekt financiar per vleren 126,900 leke dem ekonomik.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Besim Bileri, Besmir Paja dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT